

UDHËZIM
Nr. 4, datë 3.2.2022

**PËR PROGRAMIN, TRAJNIMIN, TESTIMIN DHE LËSHIMIN E CERTIFIKATËS
PËR DREJTUESIT E MJETEVE, QË KRYEJNË TRANSPORTIN E MALLRAVE TË
RREZIKSHME DHE TARIFAT PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; neneve 38, 63, të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”; dhe neneve 115/1, 119, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është ndërgjegjësimi i drejtuesve të mjeteve për rreziqet që lindin gjatë transportit të mallrave të rrezikshme dhe dhënien e informacionit bazë të domosdoshëm, nëpërmjet trajnimit, për minimizimin e mundësive të një incidenti, që mund të ndodhë dhe nëse ndodh, të jenë të aftë për marrjen e masave për sigurinë e jetës së tyre, të njerëzve dhe të mjedisit, për të kufizuar sa më shumë që të jetë e mundur pasojat.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Fusha e zbatimit është:

- a) zbatimi i ligjit nr. 118, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, dhe implementimi i “Marrëveshjes për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)”;
- b) përcaktimi i procedurave për trajnimin dhe testimin e drejtuesve të mjeteve që kryejnë transport të mallrave të rrezikshme.

Neni 3
Përkufizime

1. “ADR” nënkupton anekset A dhe B të “Marrëveshjes për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme”, të rishikuara ose të ribotuara;
2. “Autoritet kompetent” nënkupton ministrinë përgjegjëse për transportin;
3. “Certifikatë trajnimi e drejtuesit të mjetit ADR”, kudo në tekst “certifikatë trajnimi”, nënkupton certifikatën e kualifikimit të drejtuesve të mjeteve, që kryejnë transport të mallrave të rrezikshme, të përcaktuar në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 118, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme” dhe sipas modelit në aneksin e këtij udhëzimi, në përputhje me kapitullin 8.2, pika 8.2.2.8.5 të ADR-së:
 - a) lëshuar mbas shpalljes fitues në testimet e njohurive të fituara në trajnimin fillestar për kursin e njohurive bazë dhe të specializuara, për një ose disa nga klasat e mallrave të rrezikshme apo edhe për shtimin e tyre;

b) lëshuar brenda afatit të vlefshmërisë së certifikatës së mëparshme, mbas shpalljes fitues në testimin e njohurive të fituara në trajnimin për rifreskimin e njohurive;

c) konvertuar, kur është e lëshuar nga autoriteti kompetent përkatës të një shteti tjetër, sipas kapitullit 8.2 të ADR-së.

4. “Drejtues mjeti i trajnuar” nënkupton personin e trajnuar, emri i të cilit ndodhet në regjistrin e kursit të trajnimit.

5. “Institucion trajnimi” nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

6. “Kurs trajnimi i miratuar” nënkupton kursin e trajnimit të organizuar nga institucioni i trajnimit, që realizohet mbi bazën e programeve mësimore të njohurive teorike dhe praktike, të miratuara nga ministri.

7. “Kandidat” nënkupton një drejtues mjeti i pranuar për të ndjekur kursin e trajnimit dhe pajisjen me certifikatën e trajnimit, pasi është shpallur fitues i testimit të njohurive të fituara në një kurs trajnimi për njohuritë përkatëse.

8. “Ministër” nënkupton ministrin përgjegjës për transportin.

9. “Regjistër i kursit të trajnimit” nënkupton regjistrin e shkruar dhe atë elektronik të institucionit të trajnimit (regjistrin kombëtar të drejtuesve të mjeteve të DPSHTRR-së), për pjesëmarrësit në kurse trajnimi, sipas temave të programit mësimor të miratuar nga ministri.

Neni 4

Plotësimi i kushteve mbi mjedisin, infrastrukturën, organizimin dhe bazën didaktike

1. Institucioni i trajnimit duhet të zotërojë:

a) një ambient me sipërfaqe jo më pak se 30 m², i cili duhet të jetë i pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme për zhvillimin normal të kursit (ndriçim dhe ventilim të mjaftueshëm, mjetet për mbrojtjen nga zjarri (MNZ), ambient hidrosanitar, sipas rregullave në fuqi dhe me ujë të vazhdueshëm, tavolina për instruktorin e teorisë dhe kandidatët, tabelë shkrimi, pajisje kompjuterike për prova testi, projektor, materialet didaktike për zhvillimin e kurseve të trajnimit etj.);

b) mjete, pajisje mbrojtëse dhe ndërhyrëse dhe elemente të përshtatshme për të mësuar dhe për të kryer praktikën e shuarjes së zjarrit.

2. Materiale mësimore

Për ushtrimin e veprimtarisë së tij mësimore, DPSHTRR-ja duhet të ketë material didaktik të përbërë, të paktën, nga:

a) materiale multimediale, video, filmime, pankarta, panele, modele ose elemente të tjera të projektueshme ose jo, me madhësi të mjaftueshme, në mënyrë që kur të shfaqen të jenë qartë të dukshme nga çdo pikë të klasës, të cilat janë të përshtatshme për mësimdhënie;

b) rregullore dhe udhëzime që rregullojnë qarkullimin dhe transportin e mallrave të rrezikshme;

c) sinjalet rrugore vertikale që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme;

d) sinjalet e rrezikut, panelet, etiketat dhe pajisjet e tjera ose elementët sinjalizues që do të përdoren për të shënuar materialet, koltë dhe mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme në trafikun kombëtar dhe ndërkombëtar;

e) rastet e ndryshme të sinjalizimit dhe etiketimit të cisternave;

f) operacionet e ngarkimit dhe të shkarkimit të mallrave të rrezikshme në mjetet e transportit;

g) trajtimi dhe vendosja e kolive;

h) shuarjen e zjarreve dhe përdorimin e mjeteve, pajisjeve dhe elementeve mbrojtëse në dispozicion;

i) sjellja dhe ndihma e parë në rast incidenti ose aksidenti trafiku.

3. Pajisjet muldimediale për projektionin efektiv të materialit të përmendur në pikën 2.

4. Një manekin për reaminacionin kardiopulmonare, frymëmarrjen gojë më gojë, masazh të jashtëm kardial dhe vlerësimin e pulsit me sistemin përkatës të regjistrimit të teknikave elementare, e gjithë kjo në funksionimin e duhur dhe kushtet e higjienës, që do të përdoren në praktikën e mësimdhënies dhe të ndihmës së parë.

5. Material grafik ose audiovizual mbi sjelljen dhe ndihmën e parë në rast aksidenti, të paktën, me përmbajtjen e mëposhtme:

- a) anatomia elementare e sistemit kardiorespirator të njeriut;
- b) teknikat e hapjes së rrugëve të frymëmarrjes;
- c) teknikat e ringjalljes kardiopulmonare;
- d) teknikat e kontrollit të gjakderdhjes së jashtme;
- e) pozicioni i qëndrueshëm anësor i të dëmtuarit;
- f) imobilizimi i frakturave.

6. Materiale të ndryshme të përbëra nga:

- a) pajisjet me të cilat çdo njësi transporti, që transporton mallra të rrezikshme, duhet të jetë e pajisur, në përputhje me dispozitat e ADR-së;
- b) një grup i plotë udhëzimesh të shkruara për drejtuesin;
- c) një model certifikatë ADR për drejtuesin;
- d) një model certifikatë miratimi për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme, sipas ADR-së;
- e) Një përmbledhje e përditësuar e legjislacionit mbi trafikun, qarkullimin e mjeteve motorike dhe sigurinë në rrugë dhe legjislacionin mbi transportin e mallrave të rrezikshme.

Për kursin që mundëson drejtimin e mjeteve që transportojnë materiale radioaktive (klasa 7), përveç materialit të treguar në seksionet e mëparshme, duhet të kenë një detektor rrezatimi dhe një dozimetër.

Neni 5

Objektivat e kursit

1. Trajnimi, që do të jepet në kurset përkatëse, do të ketë si objektiva kryesorë sensibilizimin e drejtuesit të mjeteve, në lidhje me rreziqet që vijnë nga transporti i materialeve të rrezikshme dhe t'u sigurojë atyre trajnimin thelbësor dhe informacionin bazë, në mënyrë që të minimizohet probabiliteti i një aksidenti ose incidenti, që mund të ndodhë dhe, nëse do të ndodhë, për t'i trajnuar këta drejtues mjeteve, në mënyrë që të mund të marrin masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e tyre, të palëve të treta dhe të mjedisit, si dhe për të kufizuar efektet e aksidentit ose të incidentit.

2. Rifreskimi i njohurive dhe i informacionit do të kenë, gjithashtu, objektivin e përditësimit dhe të përsosjes së njohurive të drejtuesve, veçanërisht në lidhje me inovacionet e prodhuara në çështjet e teknologjisë, rregulloreve dhe materialeve të rrezikshme, që i përkasin transportit.

Neni 6

Kërkesat e trajnimit të drejtuesve të mjeteve

1. Kërkesa të përgjithshme

1.1 Drejtuesit e mjeteve, që transportojnë mallra të rrezikshme, duhet të jenë të pajisur me certifikatë ADR të vlefshme, lëshuar nga DPSHTRR-ja, pas pjesëmarrjes dhe shpalljes si fitues në testimet e njohurive të fituara në trajnimin, për:

- a) kursin bazë;

- b) kursin e specializuar për transportin:
- me cisterna;
 - e materialeve dhe objekteve shpërthyesë të klasës 1;
 - e materialeve radioaktive të klasës 7;
- c) kursin e rifreskimit të njohurive, para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës së mëparshme.

1.2 Drejtuesit e mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme:

a) në cisterna fikse ose cisterna të çmontueshme, me një kapacitet që tejkalon 1 m³; drejtuesit e mjeteve-bateri, me një kapacitet total mbi 1 m³, dhe drejtuesit e mjeteve ose MEMU-ve (njësive prodhuese të lëvizshme të lëndëve plasëse), që transportojnë mallra të rrezikshme në cisterna-kontenierë, cisterna portative ose MEGC (kontejnerë gazi shumë elementësh), me një kapacitet individual që tejkalon 3 m³ në një njësi transporti, përveç kursit të trajnimit bazë do të ndjekin një kurs trajnimi të specializuar për transport me cisternë.

b) të klasës 1, të ndryshme nga substancat dhe artikujt e ndarjes 1.4, pika 2.1.1.5 e ADR-së, grupit të pajtueshmërisë S (shihni S1 në kapitullin 8.5 të ADR-së) ose të klasës 7, përveç kursit të trajnimit bazë do të ndjekin kurse trajnimi të specializuar, që mbulojnë të paktën temat të përcaktuara në pikën 8.2.2.3.4 ose në pikën 8.2.2.3.5 të ADR-së.

2. Kërkesa të veçanta

2.1 Njohuritë dhe aftësitë e nevojshme do të mbulohen në kurse teorike dhe ushtrime praktike dhe do të nënshtrohen testimit.

2.2 DPSHTRR-ja do të sigurojë që personeli i trajnimit të ketë njohuri të mira dhe të marrin në konsideratë zhvillimet e fundit dhe kërkesat e trajnimit, lidhur me transportin e mallrave të rrezikshme. Trajnimi duhet të jetë i kombinuar me praktikë. Programi i trajnimit do të përputhet me miratimin e referuar në pikën 8.2.2.6 të ADR-së, në lëndët e përcaktuara në pikat 8.2.2.3.2 dhe 8.2.2.3.5 të ADR-së, si dhe duhet të përfshijë edhe ushtrime praktike në mënyrë individuale (pika 8.2.2.3.8 e ADR-së).

Neni 7

Programi mësimor i trajnimit

1. Kohëzgjatja minimale e trajnimit, e secilit kurs trajnimi fillestar dhe e kursit të trajnimit rifreskues, do të jetë si më poshtë:

Tipi i kursit	Fillestarë	Rifreskim
Kurs trajnimi bazë	18 seanca mësimore + 1 seancë ushtrime	9 seanca mësimore + 1 seancë ushtrime
Kurs trajnimi i specializuar për transport në cisternë	12 seanca mësimore + 1 seancë ushtrime	6 seanca mësimore + 1 seancë ushtrime
Kurs trajnimi i specializuar për transportin e substancave dhe artikujve të klasës 1	8 seanca mësimore	4 seanca mësimore
Kurs trajnimi i specializuar për transportin e materialit radioaktiv të klasës 7	8 seanca mësimore	4 seanca mësimore

2. Për kursin e trajnimit bazë dhe kursin e trajnimit të specializuar për transportin në cisterna, nevojiten seanca mësimore shtesë për ushtrimet praktike të përmendura në pikën 8.2.2.3.8 të ADR-së.

3. Tema të mbulimit të kursit të trajnimit bazë do të jenë, të paktën:

- a) kërkesa të përgjithshme, që udhëheqin mallrat e rrezikshme;
- b) llojet kryesore të rrezikut;
- c) informacion mbi mbrojtjen e mjedisit në kontrollin e transferimit të mbetjeve;
- d) masat parandaluese dhe të sigurisë të përshtatshme për lloje të ndryshme të rrezikut;
- e) çfarë duhet bërë mbas ndodhësë së një aksidenti (ndihma e parë, siguria rrugore etj.);
- f) shënimin, etiketimin, paketimin dhe pllakat e shënimit të ngjyrosura portokalli;
- g) çfarë duhet dhe nuk duhet të bëjnë drejtuesit e mjeteve gjatë transportit të mallrave të rrezikshme;
- h) qëllimin dhe metodën e operimit të pajisjeve teknike në mjet;
- i) ndalimet për ngarkesën e përzier në të njëjtin mjet ose kontejner;
- j) masat paraprake që merren gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave të rrezikshme;
- k) informacion i përgjithshëm lidhur me përgjegjësinë civile;
- l) informacion mbi operacionet e transportit multimodal;
- m) lëvizja dhe vendosja, dhe depozitimi i paketimeve;
- n) kufizimet e trafikut në tunele dhe instruksionet për mënyrën e veprimit në tunele (parandalimi i aksidenteve, siguria, veprimet në rastin e zjarrit ose emergjencave të tjera etj.);
- o) informim mbi sigurinë.

Trajnimi praktik individual do të sigurojë aftësi për dhënien e ndihmës së parë, përdorimin e pajisjeve në përputhje me udhëzimet e sigurisë së ADR-së dhe për sigurinë rrugore.

4. Temat të mbulimit të kursit të trajnimit të specializuar do të jenë, të paktën për transportin:

4.1 me cisterna:

- i. mënyra të sjelljes/të vepruarit në rrugë, përfshirë lëvizjet e ngarkesës;
- ii. kërkesa të veçanta për mjetin;
- iii. njohuri të përgjithshme teorike të disa sistemeve të ndryshme të mbushjes dhe të shkarkimit;
- iv. dispozita të përgjithshme shtesë të zbatueshme për përdorimin e këtyre mjeteve (certifikatat e miratimit, dëshminë e shënimeve, afishimin dhe pllakat e shënimit të ngjyrosura portokalli).

5. Trajnimi praktik individual do të sigurojë aftësi për përdorimin e pajisjeve shtesë për transport me cisternë dhe për sigurimin e sigurinë në trafik:

5.1 Të substancave dhe sendeve të klasës 1:

- i. rreziqet të veçanta lidhur me substancat dhe sendet eksplozive dhe piroteknike;
- ii. kërkesat të veçanta lidhur me ngarkesën e përzier.

5.2 Të materialeve radioaktive të klasës 7:

- i. rreziqe të veçanta lidhur me rrezatimin radioaktiv jonizues;
- ii. kërkesa të veçanta lidhur me paketimin, lëvizjen, trajtimin, ngarkesën e përzier dhe vendosjen ose depozitimin e materialeve radioaktive;
- iii. masa të veçanta që duhet të merren në rast të një aksidenti, në të cilin përfshihen materiale radioaktive.

6. Për kursin bazë të trajnimit dhe kursin e specializuar për transportin në cisternë, kërkohen seanca mësimore shtesë për ushtrimet praktike për ndihmën e parë, fikjen e zjarrit dhe veprimet që duhen bërë në rast të një incidenti ose aksidenti. Kohëzgjatja e ushtrimeve praktike, si për kurset fillestare, ashtu edhe rifreskimet, duhet të jetë në lidhje me numrin e kandidatëve. Duhet të ketë të paktën një modul për çdo 6 kandidatë (fraksionet e moduleve nuk lejohen).

7. Kohëzgjatja e përgjithshme e kursit gjithëpërfshirës të trajnimit fillestar (bazë + të specializuar) do të përfshijë kohëzgjatjen e kursit të trajnimit bazë dhe të njërit nga kurset e trajnimit të specializuar: për cisternat dhe për klasat 1 ose 7.

8. Kohëzgjatja e përgjithshme e kursit gjithëpërfshirës të trajnimit rifreskues (bazë + të specializuar) do të përfshijë kohëzgjatjen e kursit të trajnimit bazë dhe të njërit nga kurset e trajnimit të specializuar: për cisternat dhe për klasat 1 ose 7.

9. Kohëzgjatja e përgjithshme e kursit gjithëpërfshirës të trajnimit rifreskues, që përfshin trajnimin praktik, zgjat së paku 16 seanca.

10. Trajnimi rifreskues, i ndërmarrë në intervale të rregullta, i shërben qëllimit të përditësimit të njohurive të drejtuesve të mjeteve dhe do të mbulojë zhvillime të reja teknike, ligjore dhe të lidhura me substancën. Kohëzgjatja e trajnimit rifreskues, duke përfshirë ushtrimet praktike individuale, do të jetë të paktën dy ditë për kurse trajnimi gjithëpërfshirëse ose të paktën gjysmën e kohëzgjatjes së caktuar për kurset përkatëse fillestare të trajnimit bazë ose fillestare të specializuar, siç përcaktohet për kurset e trajnimit në pikën 1 më lart.

11. Kohëzgjatja e çdo kursi rifreskues do të jetë së paku gjysma e kohëzgjatjes së përcaktuar në pikën 1 më lart, për secilin nga kurset fillestare të trajnimit.

12. Çdo seancë do të ketë një kohëzgjatje minimale prej dyzet e pesë minutash. Nuk mund të realizohen më shumë se tetë seanca në ditë prej dyzet e pesë minutash ose më shumë se gjashtë orë në ditë. Klasat dhe ushtrimet praktike, përveç nëse kursi mbahet në mjedise ose vende të ndryshme nga ato në të cilat ndodhet institucioni i trajnimit (DPSHTRR), do të tregohen në ambientet dhe objektet përkatëse.

13. Numri maksimal i kandidatëve, që mund të marrin mësim njëkohësisht, nuk mund të kalojë tridhjetë, i cili, përveç kësaj, do të jetë në përputhje me sipërfaqen e klasës në të cilën realizohet trajnimi me një normë prej një metër e gjysmë për kandidat, në mënyrë të tillë që të plotësojnë në çdo kohë kushtet e përshtatshme të dukshmërisë, higjienës dhe rehatisë.

14. Mungesat e pjesëmarrjes në trajnim do të jetë shkak që parandalon pjesëmarrjen në testim. Për këtë qëllim, kontrolli i duhur duhet të kryhet me anë të fletëve të nënshkrimit ose një sistemi tjetër me efikasitet të ngjashëm.

Neni 8

Struktura e trajnimit dhe ruajtja e regjistrimeve

1. Kurset e trajnimit mbulojnë kursin teorik dhe ushtrimet praktike. Kurset bazë të trajnimit dhe kurset e trajnimit të specializuar mund të jepen në formën e kurseve të trajnimit gjithëpërfshirës, të kryera në mënyrë integrale, në të njëjtin rast dhe nga i njëjti organ trajnimi.

2. Ministri mund të caktojë një ose disa persona për të inspektuar nëse kursi i trajnimit zhvillohet sipas programeve të miratuara prej tij, i cili ose të cilët janë persona që kanë njohuri dhe eksperiencë në fushën e implementimit të legjislacionit në fuqi për transportin e mallrave të rrezikshme dhe ADR-së.

3. Personeli mësimor do të përzgjidhet nga grupi i trajnuesve në DPSHTRR, njohës të mirë të legjislacionit së transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, të cilët janë marrë me trajnimin e drejtuesve të mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme ose të jenë të pajisur me certifikatë për këshilltarin e sigurisë për transportin e mallrave të rrezikshme, të cilët do të jetë përgjegjës për dhënien efektive të mësimdhënies.

a) Një trajnues i specializuar dhe i kualifikuar siç duhet në çështjet e sigurisë, transportit dhe qarkullimit të materialeve të rrezikshme, i cili do të jetë përgjegjës për dhënien e trajnimit teorik dhe, kur është e përshtatshme, trajnimin praktik në lidhje me rregullat teorike, të sigurisë dhe rregulloret e transportit kombëtar;

b) Një trajnues i specializuar, i cili do të jetë përgjegjës për dhënien e trajnimeve teorike dhe praktike për shuarjen e zjarrit dhe trajtimin e pajisjeve dhe të mjeteve që do të përdoren, si dhe për ndihmën e parë për viktimat, në rast aksidenti ose incidenti.

4. Pas miratimit nga ministri të programit mësimor për njohuritë, sipas ADR-së, institucioni i trajnimit, sipas kërkesave të kapitullit 8.2, pika 8.2.2 të ADR-së, merr masat e nevojshme, që:

a) nëpërmjet trajnuesve të saj t'iu ofrojë drejtuesve të mjeteve, të gjitha njohuritë e nevojshme teorike, përvetësimi i të cilave do t'u lehtësonte atyre kryerjen e detyrimeve përkatëse;

b) trupa e trajnimit të ketë njohuri të plota edhe për ndryshimet e mundshme të legjislacionit, që lidhen me transportin rrugor të mallrave dhe, në veçanti, të procedurave sipas ADR-së, si për dhe kërkesat e trajnimit në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme;

c) trajnimi të përfshijë zbatimin praktik të njohurive;

d) programi i trajnimit të jetë në përputhje me miratimin e dhënë;

e) programi i trajnimit, për njohuritë bazë të specializuara dhe të rifreskimit, të përfshijë ushtrime praktike, në përputhje me kapitullit 8.2, pika 8.2.2.4, të ADR-së, si dhe me programet e trajnimit të rifreskimit, në përputhje me kapitullin 8.2, pika 8.2.2.5, të saj;

f) ushtrimet praktike individuale do të zhvillohen, në lidhje me trajnimin teorik dhe të paktën do të mbulojnë ndihmën e parë, mbrojtjen nga zjarri dhe çfarë duhet bërë në rastin e një incidenti ose aksidenti.

5. DPSHTRR-ja arkivon dokumentet për një periudhë jo më pak se 6 vjet:

a) çdo personi të trajnuar, emrin e asaj/atij dhe adresën, datën, kohën dhe vendin e zhvillimit të kursit;

b) datën, kohën, vendin, emrin dhe adresën e instruktorëve, të cilët kanë kryer mësimin në kurs.

6. Të dhënat e kandidatëve, mbas shënimit në regjistrin e institucionit të trajnimit, hidhen në regjistrin elektronik kombëtar, pasi kandidati:

a) ka marrë pjesë në kursin e trajnimit të miratuar;

b) ka demonstruar aftësi për të plotësuar standardet e vendosura në kursin e trajnimit të miratuar, në lidhje me ushtrimet praktike që mbulojnë ndihmën e parë (të shpejtë), mbrojtjen nga zjarri dhe veprimet e emergjencës, sipas vlerësimeve nga trupa trajnuese e institucionit të trajnimit.

7. DPSHTRR-ja cakton një ose disa punonjës për krijimin dhe plotësimin e "Regjistri elektronik i personave të trajnuar".

Neni 9

Miratimi i kurseve dhe i programit mësimor të trajnimit

1. Kurset e trajnimit do t'i nënshtrohen miratimit nga ministria, që, gjithashtu, do të organizojë mbikëqyrjen e trajnimit dhe testimeve.

2. Aprovimi do të jepet vetëm për sa u përket kërkesave të paraqitura me shkrim.

3. DPSHTRR-ja, nëpërmjet strukturave të saj të specializuara, harton dhe i paraqet për miratim ministrit (nëpërmjet kërkesës për miratim), programin mësimor të detajuar për njohuritë mbi ADR-në (bazë, të specializuara dhe për rifreskim), leksionet përkatëse dhe pyetësin teorik, për trajnimin, testimin dhe pajisjen e kandidatëve me certifikatën e trajnimit.

4. Kërkesës për miratim i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

a) një program i detajuar i trajnimit, ku specifikohen lëndët/temat e mësuara dhe tregohet orari kohor dhe metodat mësimore të planifikuara;

b) listën e specialistëve të DPSHTRR-së, të cilët do të zhvillojnë kurset e trajnimit;

c) kualifikimet dhe fushat e aktiviteteve të personelit të mësimdhënies;

d) informacion mbi ambientet ku do të zhvillohen kurset dhe materialet mësimore, si dhe lehtësirat për ushtrimet praktike;

e) kushtet dhe numri i pjesëmarrësve në një kurs.

5. Miratimi do të jepet me shkrim nga ministria, subjekt i kushteve të mëposhtme:

a) trajnimi do të jepet në përputhje me dokumentet bashkëlidhur kërkesës;

b) ministria ka të drejtë për të dërguar persona të autorizuar të jenë të pranishëm në kurset e trajnimit, kur e shih të arsyeshme;

c) miratimi mund të pezullohet nëse kushtet e miratimit nuk përmbushen deri në plotësimin e tyre.

6. Dokumenti i miratimit duhet të tregojë nëse kurset në fjalë janë kurse të trajnimit bazë ose të trajnimit të specializuar, kurse fillestare ose suplementare të trajnimit dhe nëse ato janë të kufizuara për mallra të caktuara të rrezikshme ose të një klase të veçantë apo klasave.

7. Në qoftë se, DPSHTRR-ja, mbas dhënies së miratimit të një kursi trajnimi, synon të bëjë ndonjë ndryshim në lidhje me detaje të tilla të rëndësishme për miratimin, do të kërkojë leje paraprakisht nga ministria. Kjo procedurë zbatohet në veçanti për ndryshimet që lidhen me programin e trajnimit.

8. Kur programi i trajnimit për njohuritë mbi ADR-në, leksionet përkatëse dhe pyetësinorin teorik për trajnimin, testimin dhe pajisjen e kandidatëve me certifikatën e trajnimit, përmbush kushtet në përputhje me këtë udhëzim dhe kapitullin 8.2 të ADR-së, atëherë ministri jep miratimin për to, për grupin e instruktorëve, si dhe për grupin e specialistëve/personave nga i cili do të formohet edhe komisioni i testimit për çdo rast.

9. Programi i trajnimit i detajuar për njohuritë mbi ADR-në, leksionet përkatëse dhe pyetësinorin teorik, për trajnimin, testimin dhe pajisjen e kandidatëve me certifikatën e trajnimit është i vlefshëm për një periudhë me afat 2-vjeçar, nga data e dhënies së miratimit nga ministri, me kërkesën me shkrim të DPSHTRR-së pas hyrjes në fuqi të udhëzimit.

10. Periudha e vlefshmërisë së programit të trajnimit, leksioneve dhe pyetësinorit teorik zgjatet, kur:

a) programi mësimor nuk është i nevojshëm të ndryshojë dhe, për pasojë, të riformulohet, pasi përgjatë periudhës së vlefshmërisë së tij nuk është shoqëruar me ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet;

b) edhe nëse kanë ndodhur ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore, ato nuk e cenojnë thelbin e çështjeve që përmban programi.

11. Për rastin e ndryshimeve të akteve ligjore dhe nënligjore, jo më vonë se dy muaj pas ndryshimeve, paraqitet kërkesa në ministri për miratimin e ndryshimeve të programit mësimor për kurset e njohurive dhe, për rrjedhojë, edhe të leksioneve përkatëse dhe të pyetësinorit teorik.

12. Programi teorik i trajnimit, i miratuar më parë, nuk mund të ndryshohet nga DPSHTRR-ja, pa miratim nga ministri.

13. DPSHTRR-ja, si autoritet përgjegjës për trajnimin, do të plotësojë kushtet e vendosura nga ministri, në lidhje me kursin e trajnimit.

14. Certifikatat e trajnimit të drejtuesit të mjetit, sipas kapitullit 8.2 të ADR-së, të lëshuara nga autoriteti kompetent i një prej shteteve anëtare, Palë Kontraktuese në ADR dhe/ose një shtet anëtar të BE-së, si dhe nga një shtet, bazuar në marrëveshjen dypalëshe ndërmjet këtij shteti dhe Republikës së Shqipërisë, ku drejtuesi i mjetit ADR ose subjekti i transportit është vendosur, do të njihen nga organet e transportit dhe institucionet përkatëse.

Neni 10

Testimi i njohurive të fituara në kurset e trajnimit

1. Çdo kandidat ka të drejtë për të kryer testimin, sipas kapitullit 8.2, pika 8.2.2.7, të ADR-së, nëse:

a) ka paraqitur një kërkesë së bashku me tarifën e destinuar për këtë qëllim, në përputhje me nenin 16, të këtij udhëzimi në DPSHTRR;

b) ka kryer kursin e trajnimit;

c) ka deklaruar me shkrim se ka kryer kursin e plotë të trajnimit dhe se është i aftë t'i nënshtrohet testimit të njohurive të fituara në të.

2. Testimi i njohurive të fituara, për secilin nga kurset, do të kryhet elektronikisht dhe bëhet nga komisioni i caktuar nga drejtori i përgjithshëm i DPSHTRR-së, me specialistë të përzgjedhur nga lista e miratuar nga ministri në datën dhe në ambientet e caktuar nga DPSHTRR-ja.

3. Në testim, kandidati provon që ka njohuri, dije dhe aftësi për profesionin e drejtuesit të mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme, siç parashikohet në kursin e trajnimit.

4. Testimet mbi njohuritë bazë, të specializuara dhe për rifreskim do të përputhen, me:

a) kapitullin 8.2, pika 8.2.2.7, të ADR-së;

b) kushtet e tjera, nëse ka, të vendosura nga ministri.

5. Një kandidat mund të testohet mbi njohuritë bazë dhe specializuara, pasi ka kryer trajnimin:

a) ai ka në dispozicion 1 vit për fitimin e testimit, duke filluar nga data e regjistrimit;

b) ka të drejtë të japë deri në 3 herë testimin, jo më afër se 15 ditë kalendrike nga njëri testim në tjetrin.

Testimet për kursin bazë të trajnimit

Pas përfundimit të trajnimit bazë, përfshirë ushtrimet praktike, zhvillohet një testim në kursin përkatës bazë të trajnimit, gjatë të cilit kandidati duhet të dëshmojë se ka njohuri dhe aftësi për praktikën e drejtuesit profesionist të mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme, siç parashikohet në kursin bazë të trajnimit.

Specialistët e DPSHTRR-së përgatisin një katalog (pyetësor) të pyetjeve, të cilat u referohen temave, sipas kurseve të trajnimit. Katalogu miratohet nga ministri dhe përditësohet sa herë ka ndryshime, sipas nenit 9, pika 12. Pyetjet duhet të jenë pohime, ku, afërsisht 50% e tyre të jenë pohime të vërteta dhe pjesa tjetër të jenë pohime të gabuara. Pyetjet në testim do të nxirren nga ky katalog.

Testimi bëhet tërësisht në formë elektronike. Procedurat e regjistrimit, përpunimit të të dhënave bëhen nga DPSHTRR-ja, duke zbatuar kërkesat në përputhje me pikën 8.2.2.7.1.8, të ADR-së.

Numri i pyetjeve, koha maksimale e zhvillimit të testimit dhe gabimet e lejuara janë:

- Për kursin e trajnimit bazë

Testi përbëhet nga të paktën 30 pyetje, të cilat bien në mënyrë rastësore, një pyetje për çdo temë dhe 10 pyetje nga 10 tema të ndryshme.

Koha – 45 minuta; gabimet e lejuara 6.

- Për kursin e trajnimit rifreskues, të trajnimit bazë

Testi përbëhet nga të paktën 15 pyetje, të cilat bien në mënyrë rastësore, një pyetje për çdo temë.

Koha – 30 minuta; gabimet e lejuara 3.

- Për kurset e trajnimit të specializuar

Pasi të ketë mbaruar testimin në kursin bazë të trajnimit dhe pasi të ketë ndjekur kursin e trajnimit të specializuar për transport me cisternë, për transport të substancave dhe të artikujve të klasës 1 ose për transport materialelesh radioaktive të klasës 7, kandidati do t'i lejohet të marrë pjesë në testimin që korrespondon me trajnimin.

Testi përbëhet nga të paktën 15 pyetje, të cilat bien në mënyrë rastësore. Për cisternat – 3 pyetje për çdo temë dhe 3 pyetje nga 3 tema të ndryshme; për klasën 1–7 pyetje për çdo temë dhe 1 pyetje nga një temë; për klasën 7–5 pyetje për çdo temë.

Koha – 30 minuta; gabimet e lejuara 3.

- Për kursin e trajnimit rifreskues të njërit prej trajnimeve të specializuar

Testi përbëhet nga të paktën 10 pyetje, të cilat bien në mënyrë rastësore. Për cisternat – 2 pyetje për çdo temë dhe 2 pyetje nga 2 tema të ndryshme; për klasën 1–5 pyetje për çdo temë; për klasën 7 – 3 pyetje për çdo temë dhe 1 pyetje nga një temë.

Koha – 20 minuta; gabimet e lejuara 2.

Tipi i kursit	Fillestarë			Rifreskim		
	Pyetje	Gabimet e lejuara	Koha (minuta)	Pyetje	Gabimet e lejuara	Koha (minuta)
Kurs trajnimi bazë	30	6	45	15	3	30
Kurs trajnimi të specializuar për transport në cisternë	15	3	30	10	2	20
Kurs trajnimi të specializuar për transportin e substancave dhe të artikujve të klasës 1	15	3	30	10	2	20
Kurs trajnimi të specializuar për transportin e materialit radioaktiv të klasës 7	15	3	30	10	2	20

Për kurset e trajnimit gjithëpërfshirës (fillestar ose rifreskues) për kandidatët e pajisur me trajnimin bazë dhe të njërit prej trajnimeve të specializuar:

c) pas dhënies dhe fitimit të testimit të trajnimit bazë do të jepet testimi për kursin special;

d) testimet për trajnimin bazë dhe trajnimin e specializuar (fillestar ose rifreskues), mund të jepen brenda një dite.

Neni 11

Komisioni i testimit dhe përbërja e tij

1. Testimi zhvillohet në ambientet e DPSHTRR-së, si autoriteti përgjegjës për testimin e drejtuesve të mjeteve që kryejnë transport të mallrave të rrezikshme.

2. Komisioni i testimit përbëhet nga tre persona, të cilët janë njohës të mirë të fushës së transportit rrugor të mallrave dhe, në mënyrë të veçantë, legjislacionit të brendshëm të transportit të mallrave të rrezikshme me rrugë dhe ADR-së. Anëtarët e komisionit përcaktohen me urdhër të veçantë të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së, të përzgjedhur prej tij, në çdo rast, nga grupi i specialistëve të miratuar nga ministri.

Neni 12

Certifikata e trajnimit

1. DPSHTRR-ja lëshon një certifikatë trajnimi për kandidatin, në përputhje me kapitullin 8.2, pika 8.2.8.3 të ADR-së, sipas modelit të paraqitur në aneksin e këtij udhëzimi, pasi ai është shpallur fitues i testimit të njohurive të fituara në një kurs trajnimi për njohuritë:

- a) bazë;
 - b) të specializuara për:
 - i. cisternat;
 - ii. klasat 1 ose 7;
 - c) rifreskimin e tyre, para përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës së mëparshme;
 - d) dhe ka paraqitur pagesën sipas nenit 16.
2. Certifikata e trajnimit është e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare nga data e shpalljes fitues.
3. Nëse një person aplikon për t'u pajisur me certifikatë trajnimi, sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", "d", të pikës 1 të këtij neni dhe nuk merr pjesë rregullisht në kursin përkatës të trajnimit, nuk lejohet t'i nënshtrohet testimit. Nga kjo rregull përjashtohen personat që kanë kaluar këtë testim dhe nuk janë shpallur fitues.
4. Nëse kandidati kërkon të rifitojë pajisen me certifikatë trajnimi, që përfshin kurset e trajnimit bazë dhe të specializuara, pajisja me të do të bëhet pasi ai të jetë shpallur fitues në të dyja testimet respektive (në fillim trajnimit bazë dhe më pas të specializuarin), sipas procedurave të propozuara nga DPSHTRR-ja dhe të miratuara nga ministria.
5. Kandidati i shpallur fitues, tërheq certifikatën e trajnimit pranë DRSHTTR-së, ku ka qendrën e banimit dhe po aty arkivohet dhe dosja e tij.

Neni 13

Zgjerimi/shtimi për klasa të mëtejshme dhe specializimi

1. DPSHTRR-ja ndryshon ose jo një certifikatë të vlefshme të trajnimit nëpërmjet lëshimit të një certifikate të re trajnimi, për zgjerimin/shtimin e klasave të ADR-së ose të të dyjave, kur personi mbajtës i certifikatës së trajnimit:
- a) ka pranuar të japë testimin/testimet, pasi ka plotësuar kërkesat e pikës 1, të nenit 10;
 - b) ka kaluar testimin/testimet përkatëse, sipas pikave 4 dhe 5, të nenit 10;
 - c) ka paraqitur pagesën, sipas nenit 16.
2. Kjo certifikatë e re trajnimi do të ketë të njëjtën datë të përfundimit, si certifikata e trajnimit që personi mbajtës e ka të vlefshme.

Neni 14

Rifreskimi i njohurive dhe lëshimi i certifikatës së trajnimit

1. DPSHTRR-ja zgjat periudhën e vlefshmërisë së certifikate të vlefshme të trajnimit të drejtuesit për një periudhë prej 5 vjetësh, me anën e lëshimit të një certifikate të re të trajnimit të drejtuesit, kur personi zotërues i certifikatës së trajnimit të drejtuesit, i paraprin datës së përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës ekzistuese të trajnimit të drejtuesit dhe ka:
- a) kryer kursin e trajnimit për rifreskimin e njohurive, sipas tabelës në nenin 7, pika 1;
 - b) kaluar me sukses testimin/testimet, sipas pikave 4 dhe 5, të nenit 10;
 - c) paraqitur pagesën, sipas nenit 16.
2. Certifikata e re e trajnimit, sipas pikës 1 të këtij neni, lëshohet:
- a) për një periudhë të mëtejshme 5-vjeçare, që fillon nga data e përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës ekzistuese, kur kandidati kryen testimin deri në 12 muaj para përfundimit të afatit të vlefshmërisë;
 - b) për një periudhë të mëtejshme 5-vjeçare, që fillon nga data e shpalljes fitues në testimin e njohurive, në rastin kur testimi është fituar përpara 12 muajve nga data e përfundimit të afatit të vlefshmërisë;

- c) për të njëjtat klasa që ka pasur edhe certifikata e mëparshme.
3. Certifikata e trajnimit pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë, nuk mund të rifreskohet.

Neni 15

Zëvendësimi i certifikatës së trajnimit

1. Në rastin kur një certifikatë origjinale ka humbur, vjedhur ose është e dëmtuar, duke u bërë e palexueshme, DPSHTRR-ja mund të lëshojë një certifikatë zëvendësuese trajnimi (dublikatë), nëse mbajtësi i saj ka paraqitur kërkesën dhe shkaqet për zëvendësimin e saj dhe pasi ka kryer pagesën sipas nenit 16.

2. Lëshimi i dublikatës, bëhet edhe në rastet, kur:

a) mbajtësi i certifikatës së trajnimit, për kohën që është në fuqi, do të njoftojë me shkrim DPSHTRR-në (duke paraqitur dhe dëshmi ose prova të përshtatshme), për ndryshime të mundshme të gjeneraliteteve të tij, sa më shpejtë që të jetë e mundur;

b) në këtë rast, DPSHTRR-ja mund të lëshojë një certifikatë trajnimi që reflekton ndryshimin/ndryshimet e bëra, pasi mbajtësi i certifikatës së trajnimit origjinale e ka dorëzuar atë dhe ka kryer pagesën sipas nenit 16.

3. Afati i vlefshmërisë së dublikatës, të lëshuar sipas pikës 1 ose shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2, do të ketë të njëjtën datë përfundimi si të certifikatës origjinale. Nëse certifikata origjinale e trajnimit gjendet, ajo dorëzohet në institucionin e trajnimit nga mbajtësi i dublikatës pa kthimin e pagesës.

4. Certifikata origjinale e trajnimit, e humbur, e vjedhur ose e dëmtuar, humbet vlefshmërinë e saj me lëshimin e dublikatës.

Neni 16

Tarifat

Tarifat e shërbimeve, në të cilat është përfshirë edhe TVSH-ja, për regjistrimin, trajnimin, testimin e drejtuesve të mjeteve dhe lëshimi i certifikatës së trajnimit, janë si më poshtë:

1. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve, për trajnimin dhe pajisja me vërtetimin e regjistrimit, për kursin bazë dhe të specializuar të njohurive, si dhe për kursin e rifreskimit të njohurive është 500 lekë.

2. Tarifa e një ore leksioni, për të gjitha kurset e trajnimeve, është 400 lekë dhe tarifa e plotë për çdo kurs trajnimi është:

a) Për kursin bazë:	19 orë x 400 lekë/ora = 7 600 lekë;
b) Për kursin e specializuar për transportin:	
i. me cisternë:	13 orë x 400 lekë/ora = 5 200 lekë;
ii. të substancave dhe të sendeve të klasës 1:	8 orë x 400 lekë/ora = 3 200 lekë
iii. të materialeve radioaktive të klasës 7:	8 orë x 400 lekë/ora = 3 200 lekë
c) Për kursin bazë të rifreskimit të njohurive:	10 orë x 400 lekë/ora = 4 000 lekë;
d) Për kursin e rifreskimit të specializuar për transportin:	
i. me cisternë:	9 orë x 400 lekë/ora = 3 600 lekë;
ii. të substancave dhe sendeve të klasës 1:	4 orë x 400 lekë/ora = 1 600 lekë;
iii. të materialeve radioaktive të klasës 7:	4 orë x 400 lekë/ora = 1 600 lekë.
e) Për kurset e trajnimit gjithëpërfshirës do të jetë shuma e orëve të trajnimit bazë dhe të specializuar të kërkuar.	

3. Tarifa për ritestim të njohurive, në rastet kur kandidati nuk është shpallur fitues, është 600 lekë.

4. Tarifa për zëvendësim të certifikatës së trajnimit (dublikatë), në rast humbjeje, dëmtimi apo ndryshimi vendbanimi, është 800 lekë.

5. Tarifa për pajisjen me certifikatën e trajnimit për herë të parë është 3 600 lekë.

Neni 17

Dispozita kalimtare

1. Kurset e trajnimit, që kanë funksionuar para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të vazhdojnë të jenë në fuqi deri më datën kur hyn në fuqi miratimi i programit të ri mësimor për kurset e trajnimit.

2. Certifikatat e trajnimit, që janë lëshuar deri më datën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, janë të vlefshme deri më datën e përfundimit të tyre.

3. Drejtuesit e mjeteve të pajisur me certifikatë trajnimi, të cilës i ka përfunduar afati i vlefshmërisë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, mund të ndjekin kurset e trajnimit, rifreskues (bazë + të specializuar) 1 vit mbas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

ANEKSI

MODELI I CERTIFIKATËS SË TRAJNIMIT E DREJTUESIT TË MJETIT ADR

Në përputhje me Kapitullin 8.2, pika 8.2.2.8.5, të Marrëveshjes “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme ADR”

CERTIFIKATA E TRAJNIMIT E DREJTUESIT TË MJETIT ADR ADR DRIVER TRAINING CERTIFICATE	
AL Foto e drejtuesit të mjetit	1. CERTIFIKATA Nr: CERTIFICATE No: 2. EMRI: NAME: 3. MBIEMER: SURNAME: 4. DATA E LINDJES*: DATE OF BIRTH: 5. KOMBËSIA: NATIONALITY: 6. NËNSHKRIMI: DRIVER SIGNATURE: 7. INSTITUCIONI: ISSUING BODY: 8. VLEFSHMËRIA:* VALID TO:

(Pjesa përpara)

E VLEFSHME PËR KLASËN/ KLASAT OSE NUMRAT UN Nr.: VALID FOR CLASS (ES) OR UN Nos.:	
CISTERNA TANKS	TË TJERA OTHER THAN TANKS
9. Shëno klasën/ klasat ose numrin UN nr**.: <i>Enter Class or UN Number/ s:</i>	10. Shëno klasën/ klasat ose numrin UN nr**.: <i>Enter Class or UN Number/ s:</i>

(Pjesa mbrapa)

* Formati: data/ muaji/ viti

** Zëvendësohet teksti me të dhënat e përshtatshme

Shënim: Dimensionet e certifikatës të jenë në përputhje me ISO 7810: 2003 ID-1 dhe të jetë prej materiali plastik. Ngjyra duhet të jetë e bardhë me shkronja të zeza. Ajo duhet të përmbajë veçori shtesë të sigurisë të tillë si një hologram, printim ultraviolet ose modele guilloché.